



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-05

**Prokurori kundër Salih Mustafës**

**Vendosi:** Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, Gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 20 korrik 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i Redaktuar Publik i  
Vendimit të Njëmbëdhjetë të Rishikimit të Paraburgimit**

---

**T'u njoftohet:**

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtjes së të akuzuarit**

Julius von Bone

**Mbrojtëses së viktimave**

Ani Pues

**TRUPI GJYKUES I** (Trupi Gjykues) nxjerr këtë vendim të njëmbëdhjetë mbi rishikimin e paraburgimit.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 20 maj 2022, Trupi Gjykuesi nxori “Vendimin e Dhjetë mbi Rishikimin e Paraburgimit” të Salih Mustafës (i akuzuari).<sup>1</sup>
2. Më 5 korrik 2022, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dorëzoi parashtrimet e saj në lidhje me rishikimin e njëmbëdhjetë të paraburgimit.<sup>2</sup>
3. Mbrojtësi dhe mbrojtësja e viktimave nuk dorëzuan parashtrime.

## II. PARASHTRIMET

4. ZPS-ja parashtron se mbajtja në paraburgim e të akuzuarit vazhdon të jetë e domosdoshme dhe proporcionale.<sup>3</sup>
5. ZPS-ja pretendon se dyshimi i bazuar se i akuzuari ka kryer krime që përfshihen brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara (DHS) vazhdon të ekzistojë, për arsye se nuk ka ndodhur asnjë rrethanë që nga rishikimi i dhjetë që përlligj rishikimin e këtij konstatimi;<sup>4</sup> ky dyshim, pasi janë paraqitur të gjitha provat në çështjen gjyqësore, jo vetëm se është konsoliduar, por edhe standardi që kërkohet është tejkaluar.<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-05, F00411, Trupi Gjykues I, *Vendimi i Dhjetë i Rishikimit të Paraburgimit* (Rishikimi i Dhjetë), 20 maj 2022, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F00411/RED.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-05, F00447, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Njëmbëdhjetë të Paraburgimit* (Parashtrimet e ZPS-së), 5 korrik 2022, publik.

<sup>3</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 2.

<sup>4</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 3.

<sup>5</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 3.

6. ZPS-ja parashtron se rreziku i arratisjes është real, mbetet i lartë dhe me mbylljen e procedurës së paraqitjes së provave është rritur edhe më tej.<sup>6</sup>

7. ZPS-ja gjithashtu parashtron se rreziku i pengimit të procesit përmes ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve dhe viktimave dhe/ose ndaj familjes së tyre vazhdon të ekzistojë për shkak të lidhjeve të ngushta të të akuzuarit me aparatit e shërbimit të zbulimit në Kosovë, përvojën e ngjashme, dijeninë dhe rrjetin teknik, si dhe dijeninë tij për akuzat dhe kohëzgjatjen e dënimit të mundshëm, nëse shpallet fajtor.<sup>7</sup> ZPS-ja gjithashtu pretendon se mënyra e ndërhyrjes që mund të ndodhë është ilustruar përmes dëshmime të dëshmitarëve gjatë gjykimit.<sup>8</sup>

8. ZPS-ja gjithashtu parashtron se ekziston rreziku real që, në rast të lirimit, i akuzuari do të kryejë krime të tjera, përfshirë krime kundër administrimit të drejtësisë; ky rrezik veçse është rritur me mbylljen e procedurës së paraqitjes së provave dhe duke pasur parasysh se çështja gjyqësore pritet të mbyllet së shpejti dhe aktgjykimin që pritet.<sup>9</sup>

9. Bazuar në sa më lart, ZPS-ja parashtron se paraburgimi mbetet e vetmja masë për zvogëlimin e efektshëm të rreziqeve ekzistuese dhe kohëzgjatja e paraburgimit mbetet e arsyeshme, duke pasur parasysh shpejtësinë e hapave proceduralë që u ndërmorën gjatë gjykimit.<sup>10</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Trupi Gjykses mbështetet në nenin 6(2) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), nenet 29, 31(5) dhe 53 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (Kushtetuta), nenet 3(2), 21(3), dhe 41(6) dhe (10)-(12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat

---

<sup>6</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 4.

<sup>7</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 5.

<sup>8</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 6.

<sup>9</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 7.

<sup>10</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 9-11.

e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji), dhe rregullën 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

#### IV. ANALIZË

11. Fillimisht, Trupi Gjykes rikujton se prezumimi i pafajësisë, sikurse parashikohet në nenin 31(5) të Kushtetutës, nenin 21(3) të Ligjit dhe nenin 6(2) të KEDNJ-së, është pikënisja për vlerësimin prej Trupit Gjykes të vazhimit të paraburgimit. Rrjedhimisht, vazhdimi i paraburgimit nuk mund të vendoset me lehtësi dhe i akuzuari duhet të lirohet në momentin që mbajtja e tij në paraburgim nuk është më e arsyeshme.<sup>11</sup>

##### A. DYSHIMI I BAZUAR

12. Sa i përket standardit lidhur me vazhdimin e paraburgimit, Trupi Gjykes rikujton se neni 41(6)(a) i Ligjit përcakton, si parakusht,<sup>12</sup> ekzistencën e dyshimit të bazuar se është kryer një vepër penale brenda juridiksionit të DHS-së.<sup>13</sup>

13. Në këtë kontekst, Trupi Gjykes gjithashtu rikujton konstatimin e tij të mëparshëm se, për vetë vendimin e marrë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake për konfirmimin e aktakuzës kundër të akuzuarit,<sup>14</sup> kushti i nenit 41(6)(a) të Ligjit është

<sup>11</sup> Rishikimi i Dhjetë, para. 11; KSC-BC-2020-06, IA004/F00005/RED, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm* (Vendimi mbi Apelin e Thaçit lidhur me Lirimin e Përkohshëm), 30 prill 2021, publik, para. 17; European Court of Human Rights (ECtHR), *Buzadji v. The Republic of Moldova*, no. 23755/07, [Judgment](#) [GC] (*Buzadji v. The Republic of Moldova* [GC]), 5 July 2016, para. 89.

<sup>12</sup> ECtHR, *Buzadji v. The Republic of Moldova* [GC], para. 87.

<sup>13</sup> Rishikimi i Dhjetë, para. 12.

<sup>14</sup> KSC-BC-2020-05, F00008/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës*, 5 tetor 2020, publik, para. 163(a). Konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake u bënë mbi dyshimin e bazuar mirë, standard ky që është më i lartë se sa ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit; *shih gjithashtu* F00215/RED, Trupi

përmbushur dhe konfirmuar nga një autoritet i pavarur gjyqësor pas analizimit të provave të paraqitura nga ZPS-ja.<sup>15</sup> Gjithashtu, Trupi Gjyqësor së fundi, në “Vendimin mbi Mocionin e Mbrojtjes sipas rregullës 130(1) për Rrëzimin e Ndonjë apo të Gjitha Akuzave në Aktakuzë”, konstatoi se provat e paraqitura nga ZPS-ja gjatë gjykimit, nëse pranohen, mund të shërbejnë si bazë për vendimin e fajësisë për Pikat 1-4 të Aktakuzës, sipas një apo më shumë formave të përgjegjësisë penale për të cilat akuzohet i akuzuari.<sup>16</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjyqësor konstaton se kushti sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit vazhdon të përmbushet.

## B. DOMOSDOSHMERIA E PARABURGIMIT

14. Trupi Gjyqësor rikujton standardin që duhet zbatuar në lidhje me vlerësimin nëse vazhdimi i paraburgimit të akuzuarit është i domosdoshëm, si dhe rëndësinë e arsytimit specifik (të çështjes) në të cilin mbështetet Trupi Gjyqësor, sikurse theksohet nga Paneli i Gjykatës së Apelit.<sup>17</sup> Konkretisht, sa u përket të gjitha rreziqeve sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit, ajo që duhet të kryejë Trupi Gjyqësor është vlerësimi i rrezikut.<sup>18</sup>

### 1. Rreziku i arratisjes

15. Në lidhje me rrezikun e arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i) të Ligjit, përveç argumenteve që ZPS-ja përsëriti në parashtrimet e mëparshme,<sup>19</sup> Trupi Gjyqësor

---

Gjyqësor I, *Versioni i Redaktuar Publik i Vendimit të Gjashtë të Rishikimit të Paraburgimit*, 23 shtator 2021, publik, para. 15.

<sup>15</sup> Rishikimi i Dhjetë, para. 13.

<sup>16</sup> KSC-BC-2020-05, F00326, Trupi Gjyqësor I, *Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes sipas Rregullës 130(1) për Rrëzimin e Ndonjë Akuze, apo të Gjitha Akuzave në Aktakuzë*, 23 shkurt 2022, para. 33, 39.

<sup>17</sup> Vendimi mbi Apelin e Thaçit në lidhje me Lirimën e Përkohshëm, para. 22. *Shih gjithashtu*, KSC-BC-2020-05, F00127, Trupi Gjyqësor I, *Vendim i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit* (Rishikimi i Katërt), 25 maj 2021, publik, para. 15-17.

<sup>18</sup> Rishikimi i Katërt, para. 17.

<sup>19</sup> Parashtrimet e ZPS-së, para. 4, dhe poshtëshënimi 15; KSC-BC-2020-05, F00355, Trupi Gjyqësor I, *Vendimi i Nëntë i Rishikimit të Paraburgimit* (Rishikimi i Nëntë), konfidencial, para. 16. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F00355/RED.

nuk e konsideron argumentin shtesë të afrimit të aktgjykimit sipas nenit 43 të Ligjit mjaftueshmërisht të fortë sa ta bindë që të ndryshojë konstatimin e mëparshëm lidhur me rrezikun e arratisjes.<sup>20</sup> Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se i akuzuari nuk përbën rrezik arratisjeje dhe ky rrezik, edhe në rast se është i pranishëm, mund të zvogëlohet në masë të mjaftueshme me anë të kushteve që i caktohen atij në bazë të nenit 41(12) të Ligjit dhe rregullës 56(5) të Rregullores.

## 2. Rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së

16. Sikurse është konstatuar më parë nga Trupi Gjykses, ekziston rreziku sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit që i akuzuari të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së përmes ndërhyrjes ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose ndaj familjeve të tyre.<sup>21</sup> Lidhur me këtë, Trupi Gjykses është mbështetur në një sërë faktorësh, që u morën parasysh në tërësi: (i) dijenia e të akuzuarit për akuzat dhe dënimi i mundshëm i gjatë, në rast se shpallet fajtor, mund t'i shërbejnë atij si motiv për ndërhyrje ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre; (ii) dijenia e të akuzuarit të identiteteve të të gjithë dëshmitarëve të ZPS-së, lidhja e tij me aparatën e shërbimit të zbulimit të Kosovës, përvoja e tij si oficer i zbulimit, lidhja e tij me disa dëshmitarë dhe kuadri i kufizuar i çështjes ia bëjnë atij më të lehtë që mundësisht të ndërhyjë ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre dhe më përgjithësisht, të pengojë ecurinë e procesit; (iii) disa dëshmitarë të mbrojtur kanë dëshmuar për raste kur ata dhe/ose familjet e tyre kanë qenë objekt i kërcënimeve dhe frikësimeve (jo të drejtpërdrejta), dhe kanë shprehur frikë për të dëshmuar në procesin aktual; (iv) dëshmitarët kanë përmendur atmosferën e përgjithshme të ndërhyrjes dhe frikësimit që mbizotëron në Kosovë kundër

---

<sup>20</sup> Rishikimi i Dhjetë, para. 21; Rishikimi i Nëntë, para. 15-17 duke iu referuar KSC-BC-2020-05, F00295/RED, Trupi Gjykses I, *Version i Redaktuar i Vendimit të Tetë mbi Rishikimin e Paraburgimit* (Rishikimi i Tetë), 21 janar 2022, publik, para. 7 dhe 18.

<sup>21</sup> Rishikimi i Tetë, para. 20-23; Rishikimi i Dhjetë, para. 19.

personave që kritikojnë ish-anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfshirë të akuzuarin; dhe (v) ekziston rrezik i madh që – ndonëse është në paraburgim – i akuzuari t'u tregojë të akuzuarve të tjerë që mbahen aktualisht në paraburgim nga DHS-ja identitetet e dëshmitarëve të mbrojtur nga ZPS-ja.<sup>22</sup>

17. Trupi Gjykses nuk sheh arsye që të heq dorë nga faktorët e lartpërmendur dhe që t'i shmanget konstatimit që bazohet në ta, sepse mungojnë faktorë bindës që tregojnë të kundërtën. Në veçanti, Trupi Gjykses rikujton se për vlerësimin nëse ekziston rreziku i pengimit në të ardhmen nuk nevojiten prova se ka ndodhur pengim në të kaluarën.<sup>23</sup> Gjithashtu, Trupi Gjykses përsërit se përvoja e të akuzuarit në zbulim ka një bazë të fortë, duke pasur parasysh se përpara se të arrestohej ai ishte oficer i lartë në Drejtorinë e Inteligjencës në Ministrinë e Mbrojtjes së Kosovës.<sup>24</sup> Për këtë arsye, kontaktet dhe lidhjet e krijuara më parë janë të rëndësishme edhe sot. Kjo, së bashku me dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së në lidhje me rastet e frikësimit dhe ndërhyrjes,<sup>25</sup> në kuadër të kontekstit të atmosferës së përgjithshme të frikësimit, përbëjnë faktorë të fortë që mundësojnë rrezikun e pengimit, brenda kuptimit të nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se disa dëshmitarë që dhanë dëshmi në lidhje me këtë janë fqinjë të të akuzuarit ose kushërinj, gjë që ia bën atij edhe më të lehtë kontaktimin dhe ndërhyrjen e drejtpërdrejt ndaj tyre.<sup>26</sup>

18. [REDAKTUAR].<sup>27</sup> [REDAKTUAR].<sup>28</sup>

---

<sup>22</sup> Rishikimi i Nëntë, para. 18.

<sup>23</sup> Rishikimi i Dhjetë, para. 17. *Ngjashëm*, KSC-BC-2020-06, IA001/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit Kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, publik, para. 38.

<sup>24</sup> 069404-TR-ET, Pjesa 1, f. 5; KSC-BC-2020-05, F00009/CONF/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 26 janar 2021, para. 20.

<sup>25</sup> Rishikimi i Tetë, para. 20-22; Rishikimi i Dhjetë, para. 17.

<sup>26</sup> Rishikimi i Nëntë, para. 22.

<sup>27</sup> [REDAKTUAR].

<sup>28</sup> [REDAKTUAR].

19. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton që vazhdon të ekzistojë rreziku se i akuzuari do të pengojë procesin e DHS-së përmes ndërhyrjes ndaj viktimave dhe dëshmitarëve dhe/ose familjeve të tyre.

### 3. Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

20. Trupi Gjykses rikujton se, meqë kushtet e përcaktuara në 41(6)(b) të Ligjit janë si alternativë e njëri-tjetrit, me përmbushjen e njërit prej këtyre kushteve nuk është e nevojshme të shqyrtohen kushtet e tjera për vazhdimin e masës së paraburgimit.<sup>29</sup>

21. Pasi ka konstatuar se ka mundësi mjaftueshmërisht reale që i akuzuari të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së, përfshirë përmes ndërhyrjes ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre,<sup>30</sup> Trupi Gjykses konstaton se nuk ka nevojë të shqyrtojë rrezikun e përcaktuar në nenin 41(6)(b)(iii) të Ligjit.<sup>31</sup>

### 4. Përfundim

22. Duke pasur parasysh vlerësimet e mësipërme, Trupi Gjykses konstaton se ekzistojnë arsye të artikuleshme për të besuar se vazhdon të ekzistojë rreziku i pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së, përcaktuar në nenin 41(6)(b)(ii) të Ligjit.

#### C. LIRIMI ME KUSHT

23. Trupi Gjykses rikujton se masa e paraburgimit duhet të vazhdohet vetëm nëse nuk ka masa më të buta që mund të zvogëlojnë mjaftueshëm rreziqet e përcaktuara në

---

<sup>29</sup> Rishikimi i Dhjetë, para. 20.

<sup>30</sup> *Shih sipër* para. 19.

<sup>31</sup> Rishikimi i Dhjetë, para. 21.



nenin 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit.<sup>32</sup> Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses ka detyrimin që të shqyrtojë dhe vlerësojë, *proprio motu*, të gjitha kushtet e arsyeshme që mund t'i caktohen një të akuzuari.<sup>33</sup>

24. Trupi Gjykses përmes referimit përfshin konstatimet e tij në Rishikimin e Nëntë në lidhje me lirimin me kusht që vazhdojnë të vlejné edhe sot.<sup>34</sup> Trupi Gjykses gjithashtu rikujton faktorët e identifikuar më sipër në lidhje me rrezikun e pengimit të procesit të DHS-së.<sup>35</sup> [REDAKTUAR].<sup>36</sup>

25. Duke pasur parasysh sa më lart, Trupi Gjykses gjykon se, në rast se lirohet i akuzuari, asnjë kusht nuk do të mund të kufizojë ose monitorojë përshtatshëm kontaktet dhe komunikimet e tij për zvogëlimin e mjaftueshëm të rrezikut të pengimit të procesit të DHS-së.<sup>37</sup> Nuk ka ndodhur asnjë rrethanë që nga Rishikimi i Dhjetë që do të mund të ndryshonte këtë konstatim.

26. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se asnjë nga kushtet dhe asnjë nga kufizimet shtesë që mund të përcaktojë Trupi Gjykses, nuk do të zvogëlonin në masë të mjaftueshme rrezikun e pengimit të procesit të DHS-së. Për këtë arsye, i akuzuari duhet të mbetet në paraburgim.

#### D. ARSYESHMËRIA E KOHËZGJATJES SË PARABURGIMIT

27. Trupi Gjykses vë në dukje, së pari se i akuzuari ka të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm ose për t'u liruar në pritje të gjykimit dhe lidhur me

---

<sup>32</sup> Rishikimi i Dhjetë, para. 23; KSC-CC-PR-2020-09, F00006, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020, 22 maj 2020, 22 maj 2020*, publik, para. 70.

<sup>33</sup> Rishikimi i Dhjetë, para. 23. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, IA003/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, publik, para. 86.

<sup>34</sup> Rishikimi i Nëntë, para. 30-34.

<sup>35</sup> *Shih sipër* para. 16-19.

<sup>36</sup> *Shih sipër* para. 18.

<sup>37</sup> Rishikimi i Dhjetë, para. 25.

këtë, rikujton detyrimin e vet në vijimësi për të vlerësuar arsyeshmërinë e paraburgimit të akuzuarit pas hapjes së çështjes gjyqësore deri kur të jetë marrë një vendim mbi akuzat e ngritura kundër tij, ose deri kur procesi gjyqësor të ketë përfunduar.<sup>38</sup>

28. Në rrethanat e çështjes gjyqësore aktuale, i akuzuari ndodhet në paraburgim për 22 muaj që prej arrestimit dhe transferimit të tij në objektin e paraburgimit të DHS-së, më 24 shtator 2020. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se i akuzuari akuzohet për krime të rënda lufte sipas nenit 14 të Ligjit, përfshirë vrasje dhe torturë, që pretendohet se janë kryer sipas shumë formave të përgjegjësisë penale në bazë të nenit 16 të Ligjit. Trupi Gjykses nuk ka identifikuar asnjë periudhë ndërprerjeje në procesin kundër të akuzuarit para DHS-së, që do të çonte në përfundimin se kohëzgjatja e paraburgimit është bërë e paarsyeshme. Trupi Gjykses vë në dukje, në veçanti se: (i) gjykimi filloi, siç ishte planifikuar, më 15 shtator 2021; (ii) ZPS-ja mbylli paraqitjen e provave të veta më 4 shkurt 2022;<sup>39</sup> (iii) Mbrojtja mbylli paraqitjen e provave të veta më 26 maj 2022;<sup>40</sup> (iv) Trupi Gjykses mbylli procedurën e paraqitjes së provave më 20 qershor 2022;<sup>41</sup> dhe (v) seanca e deklaratave përmbjllëse është planifikuar për 13-15 shtator 2022, me 16 shtatorin 2022 si ditë rezervë.<sup>42</sup>

29. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk gjykon se i akuzuari është mbajtur në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme.

---

<sup>38</sup> Rishikimi i Dhjetë, para. 27.

<sup>39</sup> KSC-BC-2020-05, F00308, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë për Mbylljen e Paraqitjes së Provave në përputhje me Rregullën 129*, 4 shkurt 2022, publik.

<sup>40</sup> KSC-BC-2020-05, F00421, Mbrojtja, *Njoftim i Mbrojtjes sipas Rregullës 131 për Mbylljen e Paraqitjes së Provave të Mbrojtjes*, 26 maj 2022, publik.

<sup>41</sup> KSC-BC-2020-05, F00439, Trupi Gjykses I, *Vendim për Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave dhe Çështje në lidhje me To* (Vendimi për Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave), 20 qershor 2022, publik.

<sup>42</sup> Vendimi për Mbylljen e Procedurës së Paraqitjes së Provave, para. 25(e).

## V. VENDIM

30. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues:

- a. **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të të akuzuarit;
- b. **URDHËRON** ZPS-në dhe mbrojtësen e viktimave, nëse dëshiron, të dorëzojnë parashtrime lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit deri të **hënën, 5 shtator 2022**; dhe
- c. **URDHËRON** Mbrojtjen të dorëzojë parashtrime lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit, nëse dëshiron, deri të **martën, 13 shtator 2022**.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi-Feld-Folia  
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E mërkurë, 20 korrik 2022

Hagë, Holandë.